

VENDIM
Nr. 54, datë 1.2.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.389, DATË 12.6.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS
DIPLOMATIKE DHE ASAJ TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen 1, bashkëlidhur vendimit, pikat 36 dhe 44, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“36. Funksionarët ndërkombëtarë, përfaqësues ose anëtarë të organizatave ndërkombëtare me shtetësi shqiptare, të emëruar, të kandiduar nga shteti shqiptar ose që përfaqësojnë interesat e shtetit shqiptar në këto organizata.

44. Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me miratimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, për shkak të specifikës së funksionit apo të detyrës shtetërore që kryejnë.”.

b) Në lidhjen 2, bashkëlidhur vendimit, pika 18, ndryshohet si më poshtë vijon:

“18. Funksionarët dhe nëpunësit publikë, me miratimin e ministrit përgjegjës për punët e jashtme, për shkak të specifikës së funksionit apo detyrës shtetërore që kryejnë.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe institucionet e tjera publike, zyrtarët apo subjektet e të cilëve pajisen me pasaporta diplomatike apo shërbimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama